

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A- 090/2014**

**Prishtinë, 25 Nëntor 2015**

Në çështjen juridike të:

**U. K.**

Përfaqësuar nga Drejtori i Bordit

M. R.

Pejë

Përfaqësuar nga

**A.V. (avokat)**

Prishtinë

***Paraqitësi i ankesës/Pala ankuese***

**kundër.**

**N. P. B.**

Prishtinë

*Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/215/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13398), të datës 21 Gusht 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 25 Nëntor 2015, mori këtë:

## AKTGJYKIM

**Hidhet poshtë si e paafatshme ankesa e U. K. Sh.p.k nga Prishtinë kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/215/2013, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA13398, të datës 21 gusht 2013.**

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 7 shtator 2006, M. R, duke vepruar si përfaqësues i autorizuar i kompanisë U. K. Sh.p.k. (në tekstin e mëtejme: paraqitësi i kërkesës), ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-posedimin dhe kompensimin për shfrytëzim të paligjshëm të 12 shtëpive që ndodhen në rrugën “Çesmja e bardhë” në Prishtinë, me sipërfaqe totale prej 2.072.24 m<sup>2</sup>.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij ai në AKP dorëzoi kontratën e ndërtimit të datës 1997 të nënshkruar me N.P.B.nga Prishtina.
3. Njoftimi i kërkesës është bërë duke e publikuar atë në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së nr.11 dhe në Buletinin e zyrës për prona të UNHCR-së më datën 25 prill 2013, sipas raportit të njoftimit dhe konfirmimit të bërë nga AKP-ja.
4. Shfrytëzuesi i tanishëm i pronës: N. P. B. nga Prishtina e kishte kontestuar kërkesën kur ishte kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës, por nuk kishte paraqitur ndonjë provë mbështetëse.
5. Më 21 gusht 2013 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës e refuzoi kërkesën në Vendimin e vërtetuar me numër KPCC/D/R/215/2013.
6. Më 2 dhjetor 2013, Vendimi iu dorëzua paraqitësit të kërkesës/palës ankuese. Palës përgjegjëse në kërkesë vendimi iu dorëzua më 12 nëntor 2013.
7. Më 24 janar 2014 paraqitësi i kërkesës, i përfaqësuar nga avokati A. V, paraqiti ankesë në Agjencinë Kosovare të Pronës mbi bazën se Vendimi përmban gabim thelbësor dhe shkelje të rëndë të së drejtës materiale dhe procedurale, dhe se mbështetet në vërtetim të gabuar dhe të mangët të fakteve.

### **Arsyetimi ligjor:**

8. Ankesa është e paafatshme. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 thekson si në vijim:  
*”Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme të Kosovës”.*
9. Pala ankuese Vendimi i KKKPK-së iu dorëzua më 2 dhjetor 2013, prandaj afati kohor për të paraqitur ankesë përfundoi më 2 janar 2014. Megjithatë, pala ankuese paraqiti ankesë më 24 janar 2014. Kjo do të thotë se ankesa është paraqitur jashtë afatit kohor të parashikuar me ligj. Pala ankuese nuk ka dhënë ndonjë arsye për paraqitjen e vonshme të ankesës dhe Gjykata nuk mund të zbulojë ndonjë arsye për vonesë.
10. Prandaj, ankesa u hodh poshtë si e papranueshme mbi baza procedurale (Neni 13.3(b) i Ligjit nr. 03/L-079). Si rrjedhojë, Gjykata Supreme nuk ka mundur t'i shqyrtojë bazat e paraqitura në ankesë.

### **Këshillë ligjore**

11. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit**

**Anna Bednarek , Gjyqtar i EULEX-it**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**